Flash Ish gjyqtarja e Krujës, Enkelejda Hoxha dënohet për korrupsion, lironte të fortët nga qelia

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1  Lironte 'të fortët' nga qelia, Apeli konfirmon: Dënohet me 3 vite burg ish gjyqtarja e Krujës, Enkelejda Hoxha! Në fuqi edhe dënimet e tjera

2  Qarkulloni me automatik me silenciator në makinë, arrestohet 2 persona! U gjendet dylbi e montuar dhe krehër me 21 fishekë

3  FOTOLAJM/ Shokuese në Durrës, prindërit nxjerrin fëmijët e zhveshur për të lypur në rrugë, madje 'nën hundën' e policisë! Askush nuk reagon

4  Rama vizitë zyrtare në Turqi, takon presidenti Erdogan

5  FOTO/ Kush është 30-vjeçari që vrau për një orë Rolex dhe varëse floriri 16-vjeçarin Mariglen Gjonaj







Kronikë

# Lushnje/ ‘Maskat’ të armatosur nxjerrin me forcë pronarin dhe i vjedhin Benzin! Makina e grabitur gjendet në Vlorë

*Një grabitje me armë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në rreth orës 22:00 në Lushnjë në vendin e quajtur 'Pushimi i Shoferit'*

Redaksia
10 Tetor, 08:53 | **Përditesimi: 10 Tetor, 15:48**

**LUSHNJË-** Një grabitje me armë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në rreth orës 22:00 në Lushnjë në vendin e quajtur 'Pushimi i Shoferit'.

Report Tv mëson se dy persona armatosur dhe të maskuar kanë ndaluar një makinë tip ‘Benz’ me targa AA 390 PO e cila drejtohej nga Martino Peqini, dhe pasi e kanë detyruar që të zbresë dhe e kanë dhunuar, i kanë marrë makinën dhe janë larguar në drejtim të Fierit.



LEXO EDHE:
**Para me prejardhje kriminale, 40-vjeçarit në Fier i gjenden 44 mijë paund brenda makinës**

Drejtuesi i makinës është banor i fshatit Sopez të bashkisë Divjakë dhe ka njoftuar menjëherë policinë, e cila ka ngritur postoblloqe, por nuk ka arritur që të kapë autorët.

Zona ku ka ndodhur grabitja është mbuluar me pamje nga shumë kamera sigurie të bizneseve përreth e cila mund të ndihmojë policinë për idnetifikimin e autorëve të grabitjes.

Ndërkohë në një njoftim paraprak policia e qarkut Fier tha se nuk janë përdorur armë duke e cilësuar ngjarjen “vjedhje me dhunë”.

> *'Mbrëmjen e djeshme, kallëzon shtetasi M. P., banues në Divjakë, se në vendin e quajtur "Pushimi i shoferit", Lushnjë, persona të paidentifikuar, i kanë marrë me dhunë, automjetin tip "Benz", me të cilin po udhëtonte.Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.'- njofton policia.*

Sakaq Report Tv mëson se 'Benzi' i vjedhur në Lushnjë është gjetur në Vlorë.

**Rendit zhvillimet sipas orarit:** Të Fundit

Ora 14:51
## U grabit me armë në Lushnjë, makina e vjedhur gjendet në Vlorë

Makina tip ‘Benz’, në pronësi të Martino Peqinit, e cila ju grabit me armë nga dy persona mbrëmjen e kaluar në vendin e njohur si Pushimi i Shoferit në Lushnjë, është gjetur në Vlorë.

M.Q./B.K./Shqiptarja.com

TAG: lushnje Fier grabitje martino peqini

Komento

### Komente

idris: 10/10/2022 12:08
ervin ndreu shefi komisariatit e ka mendjen te vjedhi dhe se ka te puna e te kodasi krimin eshte bere pale me krimin, maskarai
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Negociatat Berisha-Alibeaj, a mendoni se PD do garojë me një kandidat të përbashkët në zgjedhjet vendore?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë

Vrau e groposi 8-vjeçarin në Fier, shtyhet për herë të dytë gjyqi për Klodian Çalamanin! Nuk u paraqit në seancë
29 Shtator, 14:02

Kronikë

U kap me 44 mijë pound dhe 3 mijë euro në makinë, nën hetim për pastrim parash 40-vjeçari në Fier
29 Shtator, 13:25

Kronikë

Përfshihet nga flakët dhoma e një hoteli në Divjakë, ndërron jetë pronari! Zjarri dyshohet nga cigarja
29 Shtator, 11:38

Kronikë

Aksident i rëndë në Fier, autobusi përplaset me motorin! Humb jetën 80-vjeçari (EMRI)
29 Shtator, 10:10

Kronikë

Përplasje mes grupeve kriminale, zbardhet atentati i dështuar 6 muaj më parë në Lushnjë, në kërkim autori
28 Shtator, 12:02

Kronikë

Ditë pune ekstra, dhënie amnistie, vlerësim fiktiv sjelljeje, akuzat për 18 punonjësit e burgjeve në Fier e Tiranë! Nga Taulant Balliu, te Viktor Ymeraj e Bledar Qemalaj, ja kush përfitoi
27 Shtator, 10:55

Kronikë

Shpërdoruan detyrën, ekzekutohen 18 masa sigurie për punonjësit e burgjeve në Tiranë dhe Fier! Jepnin raporte fiktive për të burgosurit
26 Shtator, 19:38

Politikë

Balla takohet me strukturat e PS-së në Fier: Nisëm përgatitjet për zgjedhjet! Përfunduam procesin e organizimit të partisë në këtë qark
26 Shtator, 19:00

Kronikë

Kontrolle për makina me xhama të zinj e persona me armë, Policia e Vlorës dhe FNSH e Fierit shtojnë vigjilencën gjatë fundjavës
24 Shtator, 20:37

Kronikë

Vodhi rreth 2 milionë lekë nga një biznes dhe u largua, arrestohet 28-vjeçari në Fier
24 Shtator, 19:21

Kronikë

Fier/ Po mblidhte kanaçe, makina përplas për vdekje një grua në afërsi të fshatit ‘Portëz’! Drejtuesi i mjetit largohet nga vendngjarja
24 Shtator, 07:23

Kronikë

Ndërron jetë 28-vjeçari në Divjakë, gjendet i pajetë në një nga dhomat e resortit ku punonte
23 Shtator, 22:47



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje